



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Plani Strategjik i TI INSTAT
(2025–2029)

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300
www.instat.gov.al/info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje.....	3
2. Afatet kohore	7
3. Ndarja e buxhetit.....	7

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300
www.instat.gov.al/info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

1. Hyrje

Instituti i Statistikave (INSTAT) është koordinatori i Sistemit Kombëtar Statistikor (SKS) dhe prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në vend. Ai luan një rol themelor në prodhimin, analizën dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare. Për të përballuar sfidat dhe për të përqafuar mundësitë, nevojitet një strategji e Teknologjisë së Informacionit (TI) mbështetur në objektivat e institucionit. Plani Strategjik i TI përshkruan drejtimin dhe prioritetet për zhvillimin e TI në INSTAT për periudhën 2025–2029.

Përparimi i shpejtë i teknologjisë dhe kërkesat në rritje për statistika me cilësi të lartë sjellin nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm të aftësive dixhitale. Ky plan është krijuar për të adresuar kufizimet e infrastrukturës aktuale, për të forcuar masat e sigurisë kibernetike të institucionit dhe për të integruar mjete të avancuara që përmirësojnë proceset statistikore. Ai synon të sigurojë një udhërrëfyes për modernizimin e mjedisit të TI të INSTAT, për të garantuar statistika të prodhuara në mënyrë efektive, të sigurt dhe të besueshme, në përputhje me misionin e institucionit.

Duke u fokusuar në objektivat strategjike si përmirësimet e infrastrukturës, siguria kibernetike e përmirësuar dhe ngritja e kapaciteteve, ky plan është në të njëjtën linjë me tendencat në zhvillim për prodhimin e statistikave dhe analizën e të dhënave. Ai gjithashtu do të mbështesë INSTAT, si një burim i besueshëm i statistikave zyrtare si në nivel kombëtar edhe ndërkombëtar.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300
www.instat.gov.al/info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Objektivi Strategjik	Iniciativat kryesore	Detyrat	Afati kohor	Treguesit kryesorë të performancës (KPI)	Njësitë Përgjegjëse
1. Forcimi i Kuadrit të Sigurisë Kibernetike	Implementimi i mjeteve të përmirësuara të sigurisë	- Instalimi/konfigurimi i firewall të avancuara dhe sisteme të zbulimit të ndërhyrjeve	2025	% uljes së incidenteve të sigurisë kibernetike	Spektori i Administrimit të Sistemeve TI dhe DataCenter
		-Përmirësimi i antivirus në të gjitha sistemet		Numri i kontroleve suksesshme të sigurisë	Spektori i Administrimit të Sistemeve TI dhe DataCenter
	Kryerja e kontroleve të rregullta të sigurisë	-Partneritetet për auditime lidhur me sigurinë kibernetike	2025 – 2029	Numri i auditimeve kryera	Spektori i Administrimit të Sistemeve TI dhe DataCenter
		- Trajnime të punonjësve brendshëm për kontrole të rregullta		Numri i trajnimeve kryera dhe punonjësve të trajnuar nga stafi IT	Partnerët e Jashtëm
	Zhvillimi i një plani reagimi ndaj incidenteve	- Krijimi i protokolleve të përgjigjeve	2025	Koha e reagimit ndaj incidentit	Spektori i Administrimit të Sistemeve TI dhe DataCenter
		- Organizimi i ushtrimeve (drill) simuluese		Numri i ushtrimeve simuluese kryera me punonjësit e INSTAT	
2. Përmirësimi i	Përmirësimi i serverave në INSTAT	- Integrimi i serverave të rinj	2025 – 2026	Numri i përditësimeve të kryera	Spektori i Administrimit të Sistemeve

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300
www.instat.gov.al/info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Infrastrukturë s TI		- Zbatimi i përmirësimeve të serverave		% kohës të funksionimit për sistemet kritike	TI dhe DataCenter
	Modernizimi i sistemeve të brendshme	- Përditësimi i bazave të të dhënave SQL për performancë më të mirë - Integrimi i mjeteve të reja të menaxhimit të të dhënave	2025 – 2027	Numri i sistemeve/bazave të përditësuara Numri i mjeteve të reja të integruara	Drejtoria e TI
	Përmirësimi i aplikacioneve për mbledhjen e të dhënave	- Zëvendësimi i aplikacioneve ekzistuese (data entry për PAPI) me ato CATI/CAWI/CAP I	2025 – 2027	Numri i aplikacioneve të zhvilluara	Drejtoria e TI
3. Mbështetja e Inovacionit në Proceset Statistikore	Përmirësimi i sistemeve të integritetit të të dhënave	- Zhvillimi i web service për shkëmbimin e të dhënave	2025 – 2026	Numri i web service për shkëmbimin e të dhënave	Drejtoria e TI
	Zgjerimi i përdorimit të R për analizën e të dhënave	- Trajnimi i punonjësve në teknikat e avancuara R (lidhur me mbledhjen, përpunimin, publikimin, dhe transmetimin e të dhënave statistikore)	2025 – 2027	Numri i punonjësve të trajnuar, numri i trajnimeve të kryera Numri i teknologjive të reja të zbatuara	Drejtoria e TI

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300
www.instat.gov.al/info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

		- Integrimi i R në proceset ekzistuese të punës			Drejtoria e TI/DPSS
	Zbatimi i modeleve të mësimit të makinerive (ML)	- Projekte pilot për përdorimin e ML në statistikat zyrtare	2025 – 2028	Numri i projekteve për përdorimin e ML	Drejtoria e TI/DPSS
		- Shkallëzimi i modeleve të suksesshme për përdorim më të gjerë			Drejtoria e TI/DPSS
4. Ndërtimi i Kapaciteteve dhe Trajnimi	Trajnime të rregullta për sigurinë kibernetike	- Organizimi i takimeve / trajnimeve vjetore për punonjësit e TI - Përfshirja në simulime dhe studimet e rasteve	2025 – 2029	Numri i punonjësve të TI të trajnuar çdo vit	Drejtoria e TI
	Ndarja e brendshme të njohurive	- Organizimi i trajnimeve të brendshme në punë për ndarjen e njohurive - Përvetësim dhe shfrytëzimit efikas të zgjidhjeve teknologjike në përdorim në institucion - dokumentim dhe aksesim të praktikave të mira përmes mjeteve të brendshme të komunikimit dhe arkivimit të dijes.	2025 – 2029	% e stafit që ndjek trajnim mbi zgjidhje teknologjike të përdorura në institucion % e proceseve kryesore që kanë dokumentacion teknik të përditësuar	Drejtoria e TI/ Sektori i Burimeve Njerëzore

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300
www.instat.gov.al/info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

2. Afatet kohore

2025–2026

- Zbatimi i programit të trajnimit për sigurinë kibernetike dhe teknologjitë në përdorim.
- Përmirësimi i infrastrukturës: zëvendësimi i kompjuterave dhe përditësimi serverave kritikë; zëvendësimi i aplikacioneve ekzistuese (data entry për PAPI) me ato CATI/CAWI/API
- Rritja e përfshirjes në përdorimin e platformave zyrtare (email, bashkëpunim online, ruajtje cloud) pas instalimit të zgjidhjeve të reja të licencuara.

2026–2027

- Përmirësimi i infrastrukturës: zëvendësimi i aplikacioneve ekzistuese (data entry për PAPI) me ato CATI/CAWI/API
- Hartimi i një plani të integruar trajnimesh për përdorimin e gjuhës R dhe mjeteve për automatizim.
- Zhvillimi i 2–3 piloteve për automatizim të flukseve të brendshme të punës.

2027–2028

- Integrimi i analizave statistikore në R në proceset prodhimi të statistikave.
- Fillimi i testimit të moduleve të thjeshta të Machine Learning për parashikim ose klasifikim në njësitë përkatëse.

2029

- Përmirësimi i mëtejshëm i proceseve të dokumentuara dhe përputhja me objektivat strategjike për automatizim dhe siguri.
- Vlerësimi përfundimtar i progresit të arritur sipas KPI-ve të vendosur për kapacitete dhe teknologji.

3. Ndarja e buxhetit

2025–2026

Në këtë fazë fillestare të zbatimit të strategjisë së TI, fokusi kryesor është përqendruar në përforcimin e sigurisë kibernetike dhe në përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese. Investimet do të orientohen drejt:

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300

www.instat.gov.al/info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Pajisjes së institucionit me licensa të dedikuara për mjetet e sigurisë dhe komunikimit elektronik, duke përfshirë platforma të centralizuara për menaxhimin e certifikatave dixhitale, sisteme të mbrojtjes së të dhënave dhe aksesit të sigurt.
- Vendosjes në funksion të një platforme të menaxhimit të pajisjeve të lëvizshme, për të siguruar kontrollin dhe mbrojtjen e pajisjeve të përdorura në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore.
- Trajnimit i stafit të teknologjisë së informacionit dhe të përdoruesve kryesorë për përdorimin e zgjidhjeve të reja të instaluar.
- Përditësimit të pajisjeve dhe të serverave që mbështesin sistemet kritike të prodhimit statistikor, me synimin për të rritur qëndrueshmërinë dhe performancën e tyre.

2026–2027:

Gjatë kësaj periudhe fokusi zhvendoset në përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe digjitale të institucionit, me një vëmendje të veçantë për fuqizimin e kapaciteteve teknike dhe garantimin e funksionimit të pandërprerë të sistemeve kritike.

- Do të kryhet blerja e pajisjeve kompjuterike dhe punonjëse për përmbushjen e nevojave të reja të personelit dhe zëvendësimin e pajisjeve të amortizuara.
- Është planifikuar blerja e pajisjeve mbështetëse për sigurinë dhe funksionimin e vazhdueshëm të sistemit, përfshirë firewall, switche dhe bateri qendrore institucionin.
- Do të zbatohen shërbime të strukturuar për mirëmbajtjen dhe rinovimin e licensave ekzistuese, për të siguruar vazhdimësinë dhe përputhjen me kërkesat e ligjit për softuerë të licencuar dhe të sigurt.

2028–2029:

- Alokim i burimeve për shkallëzimin e projekteve të inteligjencës artificiale, përmirësimin e proceseve të integritetit të të dhënave dhe mbështetjen e sistemeve të hapura.
- Mbajtja në fuqi e licensave strategjike dhe mjeteve të sigurisë.
- Zëvendësimi i pajisjeve kompjuterike të amortizuara.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300
www.instat.gov.al/info@instat.gov.al